



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 528 Prot.

Tiranë, më datë 07.11.2024

**VENDIM**  
**Nr. 463, datë 07.11.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 07.11.2024:

**VENDOSI:**

1. Mosmiratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “*Les villages d'azur, Ksamil*”, Bashkia Sarandë, me zhvillues subjekti “**Onhezmi Marina**” sh.p.k, me argumentin se projekt – propozimi bie ndesh me:
  - Ligjin Nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;
  - Konventën lidhur me mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore 1972, ratifikuar nga Shqipëria në datën 10.07.1989;
  - V.K.M Nr. 693, datë 10.11.2005 “Për Shpalljen e Kompleksit Ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar”;
  - VKM Nr. 857, datë 19.12.2003 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të zyrës së administrimit dhe koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit”
  - VKM Nr. 583 datw 22.07.2020 “Për miratimin e Planit e Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar të Butrintit”;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.  
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Sokol ISMAILI

KRYETAR  
Blendi GONXHJA